



DITARI MUJOR

Janar 2024

Kongresi i Tretë Ndërkombëtar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", zhvilloi me sukses Kongresin e Tretë Ndërkombëtar "Trendet e fundit në kërkimin biomjekësor, gjendja aktuale e kërkimit biomjekësor në zonën e Adriatikut".

Me një pjesëmarrje të gjerë të profesorëve nga universitetet partnere të Barit, Aquil-ës etj, mjekëve, ekspertëve, profesionistëve të fushës dhe studentëve, ky kongres vulosi për të tretin vit radhazi suksesin e padiskutuar të tij, duke u kthyer në një platformë për të bashkëndarë ide, eksperiencë dhe zbulimet më të reja. Në fjalën e tij përshëndetëse, Rektori i Universitetit, Prof. dr. Skender Topi, shprehu falenderimin e tij ndaj të gjithë pjesëmarrësve dhe organizatorëve të këtij kongresi, vlerësimin për arritjet e deritanishme në fushën e biomjekësisë, si dhe cilësinë e punimeve të doktorantëve të rinj. Gjithashtu Prof. Topi, prezantoi për të pranishmit Buletinin e Parë të Ciklit të Doktoraturës në Shkencat Mjekësore Teknike, i pari në llojin e tij, punimet e të cilit do t'i shërbejnë jo vetëm shkencës dhe biomjekësisë, por edhe brezave në vijim.



Universiteti i Elbasanit merr pjesë në Marshimin e Paqes



Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar në Elbasan zhvilloi në qytetin e Elbasanit, Marshimin e Paqes, një event tradicional që mbahet çdo vit për të nxitur dialogun dhe solidaritetin kombëtar. Këtë vit, marshimi u mbajt me moton e frymëzuar: "Dialogu, mjet për solidaritet kombëtar, jo dialogut, jo konfliktit."

Në këtë event përpos komuniteteve fetare, i'u bashkuan përfaqësues të pushtetit vendor dhe deputetë, të cilët përçuan mesazhe paqje, solidariteti dhe ndërgjegjësimi.

E pranishme në këtë event ishte edhe Zëvendësrektorja e Universitetit të Elbasanit, Prof. dr. Elvira Fetahu, e cila në fjalën e saj për kumtesën "Përkushtimi i akademikëve në Dialogun mes brezave", u shpreh:

"Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ka qenë gjithmonë pjesë e kësaj ngjarjeje historike, duke sjellë studentë dhe personel akademik për të ndarë mesazhin e paqes dhe bashkëpunimit. Ky institucion i lartë i dijes ka një rol thelbësor në formimin e brezave të rinj dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e një shoqërie të harmonishme. Sot, ne marshojmë së bashku për të treguar se jemi të përkushtuar në vlerat e paqes dhe solidaritetit. Pjesëmarrja e universitetit tonë në këtë ngjarje është një shenjë e përgjegjësisë sociale dhe intelektuale drejt ndërtimit të një bote më të mirë."





DITARI MUJOR

Janar 2024

Konferenca Shkencore "Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafrimit të legjislacionit në Shqipëri"

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", nga Departamenti i së Drejtës, pranë Fakultetit Ekonomik, u zhvillua me sukses Konferenca Shkencore "Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafrimit të legjislacionit në Shqipëri". Kjo konferencë organizohet në kuadër të programit Jean Monnet, duke bashkuar për tri ditë radhazi ekspertë, akademikë dhe studentë që shfaqën interes të veçantë në fushën e integritimit evropian. Në fjalën e tij përshëndetëse Rektori i Universitetit Prof. Dr. Skender Topi, u ndal në kontributin që ka konferenca në kuadër të Programit Jean Monnet në përafrimin e Universitetit të Elbasanit me universitetet evropiane, si edhe rolin që luan si promotor për të çuar përpara mekanizmat legjislativë që na përafrojnë me Bashkimin Evropian. Rektori theksoi rëndësinë që ka ky projekt për pasurimin e kurrikulës universitare nga Departamenti i së Drejtës, duke ofruar module dhe lëndë në përshtatje me të drejtën evropiane.



Universiteti i Elbasanit pjesë e projektit EduGame



Universiteti i Elbasanit mori pjesë në takimin e parë të projektit EduGame të financuar nga Bashkimi Evropian, për rritjen e kapaciteteve të fituar nga Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me koordinatoren e projektit, Universitetin Vytautas Magnus, Kaunas, Lituani. Ky projekt ka bashkuar një grup profesorësh nga nëntë universitete që shtrihen nga rajoni Baltik, Mesdheu, Ballkani Perëndimor dhe Afrika Veriore për të filluar këtë iniciativë inovatore. EduGame është një përpjekje për të riformtuar kurrikulat në nivel bachelor dhe master, duke integruar elementë të lojrave, tregimeve digjitale dhe teknologjive të fundit si GAI dhe XR në arsim. Përmes këtij projekti synohet që mësimi për studentët të bëhet më tërheqës, efektiv, duke vendosur një standart të ri për arritjet dhe përvojën arsimore, si edhe për të arritur një ndikim të qëndrueshëm në metodologjinë arsimore në nivel global.



DITARI MUJOR

Shkurt 2024

Takim të hapur me Ministren e Arsimit dhe Sportit, Znj. Ogerta Manastirliu



Në një nismë për të përforcuar bashkëpunimin mes institucioneve të arsimit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministria Ogerta Manastirliu ka nënshkruar me Bashkinë Elbasan Marrëveshjen për Kartën e Studentit. Kjo kartë do të ofrojë tarifa të reduktuara për transport, shërbime social-kulturore dhe oferta nga bizneset. Në këtë veprimtari përshëndeti Rektori i Universitetit të Elbasanit Prof.Dr. Skender Topi dhe përfaqësuesi i Këshillit Studentor.

Në vizitën e saj në qytetin e Elbasanit, Ministria Manastirliu u ndal në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ku zhvilloi një takim të hapur me personelin akademik dhe studentët e universitetit, ku u diskutua për përmirësimin e cilësisë në veprimtarinë akademike, kërkimit shkencor dhe inovacionit, si dhe fuqizimin e infrastrukturës dhe resurseve nëpër institucionet e arsimit të lartë.

Nënshkruhet Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin "Hasan Prishtina"



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", nënshkroi Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin "Hasan Prishtina"

Në takimin e zhvilluar Rektori i Universitetit të Elbasani Prof. Dr. Skender Topi dhe përfaqësuesi i Fondacionit "Hasan Prishtina, Z. Mehmet Prishtina, shprehën angazhimin e plotë institucional për krijimin e bashkëpunimeve me qëllim promovimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe studentëve, si edhe mbështetjen në realizimin e veprimtarive të ndryshme.